



Instituti i Kosovës për Drejtësi

**Analizë e shkurtë:
Nr. 03/2017 - IKD**

LOJA ME GJYKATËN SPECIALE

Prishtinë, dhjetor 2017

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport nuk paraqet domosdoshmëri qëndrimet e donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Nëntor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive.....	4
II. Historiku	6
III. Karakteri detyruës i marrëveshjeve ndërkombëtare	7
IV. Iniciativa legjislativë për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara.....	8
V. Marrëveshjet ndërkombëtare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Holandës lidhur me Gjykatën Speciale	9
VI. Gjykatë Speciale e themeluar nga Kuvendi i Kosovës apo Gjykatë Speciale e themeluar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.....	11
VII. Rekomandim.....	12

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) reagon ndaj iniciativës së fundit të deputetëve të caktuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe ndaj mbështetjes së kësaj iniciative nga përfaqësues të lartë të Shtetit dhe nga parti të caktuara politike lidhur me plotësim ndryshimin e Ligjit mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Republika e Kosovës dhe institucionet e saj, Qeveria, Kuvendi dhe Presidenti i Republikës, përgjatë viteve 2015 dhe 2016, si rezultat i bisedimeve në Bruksel dhe me pëlqimin e mbështetjen e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve tjera mike ishin dakorduar për themelimin e Gjykatës Speciale. Ky hap i Kuvendit të Kosovës, aso kohe ishte ndërmarrë me arsyetimin se shkon në të mirë të Kosovës dhe rrugës së saj drejt konsolidimit të shtetësisë dhe forcimit të sovranitetit shtetëror.

Gjatë kohës kur zhvilloheshin bisedimet dhe në kohën kur duhej marr vendimi lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale nga institucionet e Kosovës, diplomatë ndërkombëtar, përfaqësues të Bashkimit Evropian, ShBA-ve, shteteve të Quint-it si dhe miqtë e Shtetit të Kosovës, kishin kërkuar dhe këshilluar popullin e Kosovës, se zgjidhja më e mirë për të adresuar pretendimet e ngritura nga senatori zviceran në raportin e paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme të Këshillit të Evropës, lidhur me supozimet për krime lufte gjatë viteve 1998-2000, ishte themelimi i një Gjykate Speciale nga Kuvendi i Kosovës.

Përfaqësuesit ndërkombëtar, përfshirë përfaqësues nga shtetet mike që kishin kontribuar në çlirimin e Kosovës, shpalljen e pavarësisë, shtet ndërtimin, njohjen e Kosovës nga më shumë se 100 shtete të OKB-së, pranimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, kishin deklaruar hapur se mungesa e vullnetit të institucioneve dhe liderëve politik për të themeluar një gjykatë të tillë, do të hapte rrugë që kjo gjykatë të themelohej nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, ku ndikim do të kishin edhe shtetet si Rusia, Serbia dhe shtetet tjera që kundërshtojnë pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e këtij mekanizmi, institucionet e Kosovës kishin lidhur marrëveshje kontraktuale me Bashkimin Evropian, Holandën si dhe kishin garantuar tek shtetet mike se Kosova do të përmbush në tërësi obligimet e saj ndërkombëtare në raport me këtë gjykatë. Gjithë këta hapa ishin ndërmarrë në vazhden e implemmentimit të amendamentit kushtetues nr. 24, i cili i hapte rrugën themelimit të kësaj gjykate: me amendament flet sovran si tërësi, me ligj vetëm një pjesë e tij. Kosova njëzëri dhe si Sovran foli me amendamentin e mësipërm kushtetues në gusht të vitit 2015 kur vendosi për t'i hapur rrugë themelimit të kësaj gjykate.

IKD vlerëson se iniciativa për zhbërjen e Gjykatës Speciale cenon rëndë detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, bie ndesh me vlerat dhe parimet ndërkombëtare lidhur me sundimin e ligjit për të cilat është zotuar Kosova dhe konteston rëndë subjektivitetin juridiko-ndërkombëtar të Shtetit të Kosovës sepse paraqet një shqetësim serioz të dobësisë së subjektivitetit ndërkombëtar të vendit: ky hap, po u realizua, përfundimisht tregon se Kosova ka mungesë të pasjes së zotësisë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me shtete dhe organizata ndërkombëtare si pasojë e moszbatimit të të njëjtave marrëveshje ndërkombëtare për të cilat është zotuar se do t'i zbatoi në mënyrë solemne dhe me shkrim. Ky hap, po u realizua, paraqet edhe cenim të rëndë të zakonit ndërkombëtar, diçka që Kosova nuk guxon dhe nuk duhet t'ia lejoj vetes nëse merret parasysh statusi i pakonsoliduar i shtetësisë së Kosovës. Madje, një qasje e tillë e Kosovës në raport me bashkësinë ndërkombëtare, bie në kundërshtim me parimin bazë të përgjegjësisë së shtetit në të drejtën ndërkombëtare, e cila përcakton qartë se çdo shtet që shkel një obligim ndërkombëtar duhet të mbahet përgjegjës për veprimet e tij deliktore: është përgjegjësi e shtetit që nuk respekton obligimet ndërkombëtare që menjëherë të ndaloj veprimet e tilla ose, në të kundërtën, të përballet me pasojat. Këto pasoja në rastin e Kosovës do të ishin të pariparueshme.

Kosova si një shtet i ri, i cili ende është në fazën e shtet ndërtimit, me demokraci të brishtë, ekonomikisht dhe financiarisht i varur nga ndihmat dhe mbështetja ndërkombëtare, me nivel shumë të ultë të sundimit të ligjit, në kërkim të rrugës për të forcuar subjektivitetin e tij ndërkombëtar, duhet të sigurohet që të ndërmarr veprime dhe vendime politike që ngritin besimin dhe imazhin e saj në arenën ndërkombëtare.

Çdo anashkalim nga kjo rrugë apo përpjekje e institucioneve të Republikës së Kosovës për të iu bishtnuar obligimeve ndërkombëtare, siç është rasti me Gjykatën Speciale, do të vente në rrezik shtetësinë e saj. Çka është edhe më e rëndësishme, me këtë hap Kosova do të mund të humbte besimin dhe përkrahjen e partnerëve të saj tradicional, si SHBA, Bashkimi Evropian, Britania e Madhe, Gjermania etj.

Duke u gjendur në një situatë të tillë, IKD i bën thirrje Kuvendit të Kosovës, udhëheqësve të institucioneve shtetërore dhe liderëve politik, të vazhdojnë të përmbushin obligimet kushtetuese, ndërkombëtare dhe ligjore në raport me Gjykatën Speciale, dhe mos të ndërmarrin veprime të cilat dëmtojnë subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, të cilat rrezikojnë të ardhmen dhe perspektiven euro-atlantike të popullit të Kosovës.

II. Historiku

Në janar të vitit 2011, Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës kishte miratuar raportin e raportuesit special të Këshillit të Evropës Dick Marty. Ky raport ka ngritur dyshime për kryerjen e krimeve të luftës mes periudhës kohore prej datës 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000.

Sipas raportit të miratuar, ndër tjera thuhet se “[...] krerë të lartë të ish-UÇK-së, të cilët tash udhëheqin politikën e Kosovës, shumë shpejt mund të përfundojnë si të kërkuar nga drejtësia ndërkombëtare. Ata dhe disa të tjerë po hetohen për likuidime, për krime të tjera kundër njerëzimit, trafikim organesh dhe droge, naftë dhe armësh”.

Pas daljes së këtij raporti, në shtator të vitit 2011 Bashkimi Evropian formoi Task Forcën Hetimore Speciale, për kryerjen e një hetimi të pavarur të pretendimeve të ngritura në raport dhe krimeve të tjera në lidhje me to.

Në vitin 2014, Task Forca kishte dalë me raport se ekzistonin prova të mjaftueshme që mund të përfundonin me aktakuza dhe kishte dalë me një propozim se për shqyrtimin e këtyre pretendimeve ishte i nevojshëm krijimi i një institucioni adekuat për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e tyre.

Mes Kosovës dhe faktorit ndërkombëtar ishin zhvilluar negociata lidhur me zbatimin e rekomandimit të tillë. Gjatë vitit 2014 dhe 2015 ishin zhvilluar negociata mes Kosovës dhe Brukselit me përfshirje edhe të SHBA-së për të gjetur një modalitet lidhur me themelimin e një mekanizmi që do të hetonte, ndiqte dhe gjykonte pretendimet e dala nga raporti i senatorit Dick Marty.

Si rezultat i këtyre negociatave, më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar amandamentin kushtetues, përkatësisht nenin e ri 162 të Kushtetutës së Kosovës, me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, me 71 vota të deputetëve të Kosovës.

Republika e Kosovës, po ashtu kishte shkëmbyer letra përmes Presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, baroneshës Cathrine Ashton, në vitin 2014 lidhur me themelimin e kësaj gjykate.

Kosova dhe Holanda në shkurt të vitit 2016, kishin arritur Marrëveshje në lidhje me Vendosijen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë.

Gjatë vitit 2016 dhe 2017, Gjykata Speciale kishte ndërmarr një sërë aktivitete lidhur me funksionalizimin e saj, duke përfshirë rekrutimin e gjykatësve, prokurorëve, personelit ndihmës,

miratimit të legjislacionit sekondar dhe së fundi edhe veprimi i fundit për të funksionalizuar në tërësi këtë gjykatë përmes hapjes së procesit të aplikimit për licencim të avokatëve mbrojtës për të shërbyer pranë kësaj gjykatë si mbrojtës të të dyshuarve dhe viktimave të krimit. Proces ky që ende është në zhvillim e sipër.

Teknikisht, Gjykata Speciale pa licencimin e avokatëve mbrojtës nuk mund të bëjë kërkesa për arrestim të personave të akuzuar, pasi që në një situatë të tillë, personat e arrestuar nuk do të kishin në dispozicion të drejtën themelore për të pasur avokat mbrojtës lidhur me ankesat e mundshme lidhur me arrestimin e tyre dhe caktimin e masës së paraburgimit. Pa licencimin e avokatëve mbrojtës, mbi të gjitha, veprimi i Gjykatës do të cenonte rënd Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në Kosovë ka statusin e normës kushtetuese.

III. Karakteri detyrues i marrëveshjeve ndërkombëtare

Kosova ka hyrë në marrëveshje dhe obligime kontraktuale lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale me Bashkimin Evropian dhe me Mbretërinë e Holandës. Kosova ka ratifikuar marrëveshje me Mbretërinë e Holandës lidhur me zhvendosjen e Gjykatës Speciale në këtë shtet. Kosova po ashtu përmes shkëmbimit të letrave në mes të Presidentit të Republikës dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së ka marr obligime ndërkombëtare në raport me themelimin dhe funksionalizimin e kësaj gjykate.

Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë hyrë në fuqi janë të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës, mund të tërhiqen dhe zbatimi i tyre mund të suspendohet vetëm në bazë të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, normave të së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe në bazë të procedurës së njëjtë të vendosur përmes Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

Vendimi në lidhje me tërheqjen nga një marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose suspendimin e zbatimit të saj në bazë të normave universale të së drejtës ndërkombëtare, merret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me dy të tretat (2/3) e votave pas rekomandimit të Presidentit, me iniciativë të tij ose pas propozimit nga Qeveria.

IV. Iniciativa legislative për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara

Ligji për Dhomat e Specializuara si ligj i veçantë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ka për qëllim zbatimin e nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, i cili nen përcakton se Republika e Kosovës *mund të themelojë* dhoma të specializuara dhe një zyrë të prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës dhe se organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe **me ligj të veçantë**.

Kushtetuta po ashtu ka përcaktuar se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar *mund të kenë seli në Kosovë dhe seli jashtë Kosovës*. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të ushtrojnë funksionet e tyre në të dyja selitë apo diku tjetër, sipas nevojës.¹

Kuvendi i Kosovës me qëllim të zbatimit të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës ka miratuar një ligj të veçantë lidhur me themelimin e dhomave të specializuara. Ligji mbi Dhomat e Specializuara si ligj i veçantë ka përcaktuar se selia e gjykatës do të jetë në Hagë të Holandës. Për më tepër në bazë të këtij ligji dhe amandamentit kushtetues (nenit 162), Kosova ka nënshkruar edhe marrëveshje ndërkombëtare me Mbretërinë e Holandës lidhur me zhvendosjen e kësaj gjykatë në këtë shtet, si dhe ka shkëmbyer letra me Bashkimin Evropian lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e kësaj gjykate.

Kuvendi i Kosovës me Kushtetutë ka fuqinë ligjore që të miratojë ligje, rezoluta dhe akte tjera të përgjithshme.² Në parim të gjitha ligjet në Kuvendin e Kosovës miratohen me shumicën e deputetëve prezent në kuvend dhe që marrin pjesë në votim.³ Ligjet në Kosovë, në parim inicoohen me iniciativë të Kryetarit të Kosovës, Qeverisë; iniciativën e deputetëve të Kuvendit; dhe me iniciativën e së paku dhjetë mijë (10,000) qytetarë.

Iniciativa e 43 deputetëve të Kosovës për plotësim ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, respektivisht shfuqizimit të këtij ligji, nuk hyn në kuadër të ligjeve me interes vital për Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, edhe shfuqizimi i këtij ligji përmes plotësim ndryshimit kërkon vetëm shumicën e deputetëve prezent në Kuvendin e Kosovës dhe që marrin pjesë në votim. Megjithatë, ky është një rast specifik, sepse ky ligj përbën legjislacionin implementues të një detyrimi kushtetues të Kosovës, i cili detyrim kushtetues është marrë mbi supet e Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kosovës. Përveç kësaj,

¹ Neni 162 paragrafi 7 i Kushtetutës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

² Neni 65 paragrafi 1 i Kushtetutës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

³ Neni 80 paragrafi 1 i Kushtetutës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

ky detyrim kushtetues, tutje është vënë në jetë përmes lidhjes së një marrëveshjeje të veçantë, e cila është ratifikuar nga organi kompetent kushtetues i Kosovës, Presidenti i Republikës. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, sipas nenit 19.1 të Kushtetutës, ka fuqinë më të madhe se ligji i zakonshëm e më të ulët se Kushtetuta. Kjo nënkupton se shfuqizimi i çdo ligji që prish një detyrim ndërkombëtar të Kosovës duhet të ndjekë procedurën e njëjtë dhe assesi me rrugë të tërthorta joligjore. Kjo iniciativë, për më tepër, synon që të anuloi çdo pasojë juridike që është krijuar deri më tash më marrjen nga ana e Kosovës të këtij detyrimi kushtetues dhe ndërkombëtar. Miratimi i një ligji të tillë, me fjalë tjera, do të ketë efekt juridik në derogimin e Ligjit aktual mbi Dhomat e Specializuara. Kjo në praktikë do të nënkuptonte se çdo veprim apo vendim i ndërmarrë deri më tani lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e Dhomave të Specializuara në Hagë të shpallej i pavlefshëm, respektivisht **nul**. Kjo pasi me këtë ligj është përcaktuar themelimi, organizimi, funksionet dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.⁴ Këtu nuk flitet për shfuqizim të një ligji por për abrogim të një detyrimi kushtetues dhe ndërkombëtar të Kosovës, i cili është marrë, duke u bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin zakonor ndërkombëtar.

V. Marrëveshjet ndërkombëtare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Holandës lidhur me Gjykatën Speciale

Kuvendi i Kosovës në vitin 2014, kishte miratuar Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian lidhur me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë. Pjesë e këtij ligji ishin edhe shkëmbimi i letrave në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Sigurisë, Baronessa Catherine Ashton.

Pjesë e kësaj e këtij ligji ishte edhe obligimi ndërkombëtar i Kosovës lidhur me punën Task Forcës Speciale për Hetime deri në kohën kur Kosova do të njoftohej nga Këshilli i Bashkimit Evropian lidhur me atë se hetimet apo procedimet penale kanë përfunduar.

Kosova në vitin 2016 kishte lidhur marrëveshje ndërkombëtare me Holandën lidhur me zhvendosjen e Gjykatës Speciale në Hagë të Holandës.

Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që kanë hyrë në fuqi janë të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës mund të tërhiqen dhe zbatimi i tyre mund të suspendohet vetëm në bazë të dispozitave

⁴ Neni 1 i Ligjit mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

të marrëveshjeve ndërkombëtare, normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në bazë të procedurës së vendosur përmes Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.⁵

Përfundimi apo tërheqja dhe suspendimi i marrëveshjes ndërkombëtare sipas Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve ka përcaktuar se mund të ndodhë në pajtim me dispozitat e marrëveshjes dhe në çdo kohë kur ipet pëlqimi i të gjitha palëve pas konsultimit mes shteteve kontraktuese.⁶

Praktika ndërkombëtare ka dëshmuar se qëllimi i nenit 54 të Konventës së Vjenës është të përcaktohet rregull e qartë se përfundimi i një marrëveshje ndërkombëtare apo tërheqja nga një marrëveshje ndërkombëtare mund të realizohet vetëm me pëlqimin e palëve dhe sipas formës së pajtuar mes palëve. Neni 54 i Konventës së Vjenës shërben edhe si kujtesë i rregullit *pacta sunt servante* në të drejtën ndërkombëtare që afirmon se ky rregull zbatohet lidhur me dispozitat e marrëveshjes që rregullojnë përfundimin apo tërheqjen e shteteve nga marrëveshjet ndërkombëtare. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe lidhur me rastet e suspendimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Praktika e së drejtës ndërkombëtare ka përcaktuar se edhe në rastet kur ndodhin rrethana të ndryshimeve thelbësore lidhur me ato që kanë qenë në kohën kur është lidhur marrëveshja dhe të cilat rrethana nuk janë paraparë nga palët nënshkruese, marrëveshja nuk mund të revokohet përveç rasteve kur ekzistenca e këtyre rrethanave përbëjnë bazë themelore për të dhënë pëlqimin e palëve për të marr obligim për të zbatuar një marrëveshje të tillë dhe nëse efekti i ndryshimit të rrethanave transformojnë në mënyrë radikale detyrimet të cilat duhet të përmbushen sipas marrëveshjes. Cilat rrethana thelbësore kanë ndryshuar në Kosovë që nga dita e marrjes së këtij detyrimi ndërkombëtar nga ana e organeve kompetente të Kosovës? Nuk ka asnjë ndryshim as thelbësor e as rutinor të rrethanave që nga koha e marrjes së këtij detyrimi, prandaj si i tillë duhet vënë në jetë sipas standardeve të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Ndryshe, Kosova dëshmon paaftësi për të plotësuar elementin bazik të të qenurit shtet: pasjen e zotësisë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale dhe për të zbatuar detyrimet e marra ndërkombëtarisht.

Ligji mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare i miratuar nga Kuvendi i Kosovës ka përcaktuar se lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare në Kosovë duhet të bëhet në pajtim me rregullat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare të kodifikuara në Konventën e Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve, dhe Konventën e Vjenës të 21 marsit 1986 për të Drejtën e Traktateve ndërmjet Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare.

Inicimi i plotësim ndryshimit të Ligjit mbi Gjykatën Speciale dhe kërkesa për shfuqizimin e këtij ligji, në praktikë do të ndikonte që Kosova automatikisht të përfundonte apo të tërhiqej nga

⁵ Neni 18 i Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

⁶ Neni 54 dhe 57 i Konventës së Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve.

marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me Bashkimin Evropian dhe Holandën. Përfundimi dhe tërheqja e Kosovës nga këto marrëveshje do të ishte në kundërshtim me të drejtën zakonore ndërkombëtare, respektivisht në kundërshtim me Konventën e Vjenës të 23 majit 1969 për të Drejtën e Traktateve dhe Konventën e Vjenës të 21 marsit 1986 për të Drejtën e Traktateve ndërmjet Shteteve dhe Organizatave Ndërkombëtare ose ndërmjet Organizatave Ndërkombëtare.

VI. Gjykatë Speciale e themeluar nga Kuvendi i Kosovës apo Gjykatë Speciale e themeluar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Gjatë vitit 2015, kur Kuvendi i Kosovës debatonte lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale dhe hezitimit të partive politike dhe deputetëve të Kosovës, lidhur me miratimin e amandamentit kushtetues dhe ligjit mbi dhomat e specializuara, përfaqësues ndërkombëtar kishin deklaruar se nëse Prishtina zyrtare nuk arrin ta themelojë Gjykatën Speciale, atëherë sipas tyre, një gjë e tillë do të kalohet në kompetencë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ambasadorja Amerikane në Kosovë, Tracey Ann Jacobson, në atë kohë kishte deklaruar se Gjykata Speciale nuk e ka për synim të gjykojë luftën dhe historinë e Kosovës. Jacobson, kishte deklaruar se nëse dështon themelimi i kësaj gjykate, atëherë kompetencat do t'i kalojnë OKB-së, dhe sipas saj, kjo për Kosovën do të ishte një Hagë e dytë.

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ian Cliff, aso kohe kishte theksuar se nëse Parlamenti i Kosovës nuk arrin ta votojë krijimin e Gjykatës Speciale, për çështje të ngritura në raportin e Dick Martit, në mënyrë të pashmangshme, kjo do t'i referohet Këshillit të Sigurimit të OKB-së, nën Rezolutën 1244. “Nuk do të jetë presion i madh për të krijuar një Gjykatë nga OKB-ja, pasi që anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, duke përfshirë edhe veten, nuk do të ketë arsye të refuzojnë një gjë të tillë”.⁷

Ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Angelika Viets, aso kohe ka deklaruar për mediat se BE-ja dhe Kosova bashkërisht kanë marrë vendim për themelimin e Gjykatës, ku për këtë sipas saj, ka pasur një letërkëmbim të BE-së me Kosovën. “Themelimi i Gjykatës është i mirë për Kosovën, sepse është e rëndësishme të mos synohet ri-negocimi i marrëveshjes për Gjykatën Speciale. Diskutimi aktual është i rrezikshëm për imazhin e Kosovës si partner serioz”. Po ashtu edhe ambasadorja Veits, kishte përmendur faktin se nëse Kosova nuk e themelon Gjykatën këtë do ta bëjë Këshilli i Sigurimit i OKB-së, dhe sipas saj, ky do të ishte kthim mbrapa në përpjekjet e Kosovës për ta forcuar sovranitetin.

⁷Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar, intervistë për gazetën Kosovainfo.

Ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, kishte deklaruar se nëse refuzohet Gjykata Speciale, kjo do të jetë shumë keq për Kosovën, sepse në atë rast Kosova do ta ketë një Gjykatë të Kombeve të Bashkuara. ‘Të refuzohet Gjykata do të jetë shumë keq për vendin, sepse pastaj do të shkojë në Gjykatën e Kombeve të Bashkuara dhe do të keni atë Gjykatë. Të paktën do të keni një Gjykatë që nuk është Gjykatë e Kombeve të Bashkuara, pasi që aty ka vende që nuk janë miq të mirë me ju dhe kanë influencë të madhe’, ishte shprehur ambasadori Bosch, gjatë një ligjërate para studentëve të Universitetit të Prishtinës, ‘Hasan Prishtina’.

Edhe anëtari i Dhomës Përfaqësuese të Kongresit të Shteteve të Bashkuara, Eliot Engel ishte deklaruar për themelimin e Gjykatës Speciale në Kosovë, gjatë fjalës së tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. ‘Unë nuk besoj se Kombet e Bashkuara, veçanërisht janë korrekte, kur kemi të bëjmë me Kosovën. Besoj se do të ketë alternativë për Gjykatën Speciale nëse ajo nuk miratohet. Mendoj se do të jetë gjykatë e OKB-së dhe ky do të jetë problem i madh për Kosovën’.

Të gjitha këto deklaramë të miqve të Kosovës ishin shqetësime reale dhe të sinqerta sepse sinjalizonin rrezikun e rrëshqitjes së Kosovës kah rruga e keqe që do të dëshmonte atë që dëshiron Rusia dhe aleatët e saj: demonstrimin se Kosova dhe lider shipi i saj nuk kanë zotësi për të vënë në jetë detyrimet e marra ndërkombëtare dhe për të luajtur rolin kushtetues që u takon. Këto deklaramë, thënë ndryshe, dëshmonin për sinjalizimin e rrezikut për zhbërjen e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare sepse vënia apo rikthimi i Kosovës nën kthetrat e KS të OKB-së definitivisht nënkupton humbje të subjektivitetit juridiko – ndërkombëtar të Kosovës.

VII. Rekomandim

Institucionet shtetërore si Presidenti i Kosovës, Kuvendi dhe Qeveria, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese duhet të ndërmarrin përsipër përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që dalin nga Kushtetuta e Kosovës, Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe detyrimeve ndërkombëtare në raport me Bashkimin Evropian, SHBA-në, Holandën dhe shtetet tjera mike.

Kuvendi i Kosovës dhe liderët politik nuk duhet të ndërmarrin veprime që rrezikojnë subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, si dhe që mund të cenojnë besimin dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar në raport me Republikën e Kosovës.

Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të sigurojnë SHBA-në, Bashkimin Evropian dhe shtetet e Quint-it në Kosovë, se Kosova do të ndërmarr veprime konkrete në kthimin e besimit të qytetarëve të saj për një shtet me institucione gjyqësore dhe prokuroriale tërësisht të pavarura që promovojnë dhe sigurojnë sundimin e ligjit në Kosovë.